

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



STUDIM PËR SEKTORIN E QUMËSHTIT

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të qumështit, mbi mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor.

STUDIM PËR SEKTORIN E QUMËSHTIT

Përgatitur nga:

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

Prof. Dr. Engjëll Skreli / Prof. Assoc. Dr. Drini Imami

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive

Tiranë, 2019

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1. HYRJE	7
2. METODOLOGJIA.....	9
3. TENDENCAT DHE PERSPEKTIVAT E SEKTORIT TË QUMËSHIT	11
3.1. Tendencat e prodhimit.....	11
3.2. Tendencat e tregtisë ndërkombëtare.....	14
3.3. Tregu.....	16
4. STRUKTURA E ZINXIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORË	21
4.1. Struktura e zinxhirit të vlerës dhe profili i aktorëve	21
4.2. Flukset në zinxhirin e vlerës dhe koordinimi i zinxhirit	26
5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT	28
6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM.....	31
6.1. Strategjia bazuar në analizën SWOT	31
6.2. Nevojat për financim	32
7. PËRFUNDIME.....	37
8. BIBLIOGRAFIA	39
9. SHTOJCAT.....	40

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Tregtia e djathit në BE-27 në vitin 2016 (000 tonë).....	16
Figura 2: Skema e zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit	21
Figura 3: Financimi sipas qasjes së zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit	35

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Ecuria e numrit të bagëtime dhe prodhimit të qumështit në periudhën 2000 - 2016	11
Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të qumështit të lopës sipas qarqeve në 2016 (tonë).....	12
Tabela 3: Shpërndarja e qumështit të të imtave sipas qarqeve në 2016 (tonë)	12
Tabela 4: Ecuria e prodhimit të djathit dhe gjalpfit (tonë).....	13
Tabela 5: Prodhimi i produkteve të bulmetit sipas llojit (2016).....	14
Tabela 6: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në produkte bulmeti (HS 04).....	15
Tabela 7: Importi dhe eksporti i djathit, Shqipëri, sipas vitit.....	15
Tabela 8: Importi i djathit dhe gjizës, Shqipëri, sipas shtetit partner kryesor, në 2016.....	15
Tabela 9: Oferta e qumështit- HS 0401 (000 tonë).....	17
Tabela 10: Oferta e djathit- HS 0406 (djathë dhe gjizë) (000 tonë)	18
Tabela 11: Konsumi i përafërt i djathit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë).....	19
Tabela 12: Shpërndarja e fermave me gjedhë për qumësht sipas përmasës.....	22
Tabela 13: Shpërndarja e fermave të mëdha me gjedhë për qumësht sipas përmasës.....	22
Tabela 14: Shpërndarja e fermave të të imtave sipas përmasës.....	23
Tabela 15: Fermat me orientim tregu të të imtave (dele dhe dhi), për 2017.....	24
Tabela 16: Kalendar i proceseve të prodhimit blegtoral me fokus te gjedhët.....	29
Tabela 17: Kalendar i prodhimit të qumështit.....	30
Tabela 18: Sektori i qumështit: Strategjia për analizën SWOT	31
Tabela 19: Nevojat e financimit për investime.....	33
Tabela 20: HARTA e rajonalizimit	40

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Blegtoria është një sektor agroushqimor shumë i rëndësishëm në Shqipëri - rreth 1/2 e fermerëve janë të angazhuar në blegtori, duke përfshirë sektorin e bulmetit. Produktet e bulmetit zënë një pjesë të rëndësishme në shportën e konsumit të familjeve shqiptare. Prodhimi i qumështit dominohet kryesisht nga qumështi i lopëve (më shumë se 4/5). Në përgjithësi, prodhimet e bulmetit kanë si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase, ndërsa bilanci i tregtisë ndërkombëtare së produkteve të bulmetit tregon një deficit strukturor. Sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi nisur nga potenciali për zëvendësimin e importit.

Gjatë dekadës së parë të tranzicionit, ka pasur një prirje rritjeje të madhe të prodhimit të qumështit (dhe produkteve të bulmetit), rritje që ka vazhduar edhe përgjatë viteve 2000. Ndërkohë që numri i gjedhëve dhe të imtave është ulur gjatë kësaj periudhe, prodhimi i qumështit është rritur, duke konfirmuar një përmirësim të rendimentit (efiçencës), e mundësuar nga investimet në raca cilësore dhe menaxhimi që lidhet me një tendencë konsolidimi për sa i përket përmasës së fermave blegtorale. Pavarësisht këtyre përmirësimeve, rendimenti i qumështit (p.sh. për lopët, që është burimi kryesor i prodhimit të qumështit) është më i ulët se rendimenti në vendet e BE-së. Përveç rendimentit të ulët, një shqetësim tjetër kryesor është mungesa e plotësisht të standardeve, gjë që e pengon Shqipërinë të eksportojë produkte bulmeti në tregjet e BE-së.

Objekti i këtij studimi është të japë një panoramë të përgjithshme të sektorit të qumështit, duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime. Ky studim ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjeve) për institucionet financiare ose për përgatitjen e produkteve dhe shërbimeve financiare. Por përdorues potencialë të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij studimi mund të jenë edhe institucionet shtetërore, shoqatat e biznesit, agjencitë e zhvillimit, akademikët dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobiznesi. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: linjë kredish dhe/ose shpërndarja e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit si edhe tregtarët me shumicë dhe pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillit të BERZH-it për Biznesin e Vogël, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Për të arritjen e objektivave të studimit janë përdorur të dhëna dhe informacione nga burime dytësore dhe parësore; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshtuese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit, dhe strategjia bazuar në analizën SWOT. Kombinimi i analizës cilësore dhe sasore ka qenë thelbësor për të identifikuar/kuptuar tendencat, boshllëqet dhe nevojat për investime.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të qumështit për mundësitë kryesore të financimit në këtë sektor. Përmirësimi i efikasitetit dhe nevoja për të përmbushur standardet e sigurisë nga përpunuesit i ka motivuar disa fermerë/sipërmarrës që të investojnë në krijimin e fermave më të mëdha të qumështit (me lopë dhe të imta), duke blerë raca më të mira dhe duke investuar në përmirësimin e stallave – investimet në krijimin e fermave të mëdha është një mundësi e mirë financimi për bankat. Nga ana tjetër dhe makineritë për prodhimin/përpunimin e ushqimit për kafshët përbëjnë gjithashtu një mundësi për financim. Investime të tjera që mund të merren në konsideratë për fermat e mëdha me lopë janë trajtimi i mbetjeve (përpunimi i plehut), prodhimi i biogazit dhe prodhimi i energjisë diellore (panelet diellore në çatitë e stallave). Mundësi të rëndësishme për financim që mund të konsiderohen për sa i përket konsolidimit të prodhimit të qumështit, përpunimit dhe marketingut janë mbështetja për sistemet e ruajtjes në temperatura të ulëta (psh. tanqe ftohës) të qumështit, investimet në fabrikat e madhësisë të mesme të përpunimit të prodhimit të qumështit dhe investimet në kompani të reja për përpunimin e qumështit në zona ku oferta e qumështit tejkalon kërkesën. Mbështetja e bizneseve që përdorin mbetjet nga përpunimi i qumështit (si p.sh. mbarështimi i derrave që mund të ushqehen me mbetjet e industrisë të përpunimit të qumështit) përbën një mundësi.

Shumë fabrika përpunimi kanë probleme me likuiditetin që lidhet me procesin e teknologjisë së prodhimit të djathit. Për këtë arsye, ekziston nevoja për kredi afatshkurtra në këtë zinxhir vlere. Gjithashtu, edhe përpunuesit e qumështit - si liderë në zinxhirin e vlerës së qumështit - mund të konsiderohen për financim sipas qasjes së zinxhirit të vlerës.

Kur përgatisin ndërhyrje në këtë sektor, institucionet financiare duhet të marrin në konsideratë se (i) mbështetja për investime varet në mënyrë thelbësore nga zhvillimet në zbatimin e standardeve të sigurisë së ushqimit (i cili është një kusht paraprak për investimet e reja në sektorin e blegtorisë), dhe se (ii) mund të përdorin bashkëfinancim për investimet: financimi nga banka i kombinuar me mbështetjen financiare publike nëpërmjet skemave mbështetëse të qeverisë shqiptare ose skemave të IPARD II. Politika aktuale e granteve të pjeshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ata kanë mundësinë për të bashkëfinancuar investimet (stallat, zinxhiri i ftohjes, përpunimi i qumështit etj.) për investimin e 100% të shumës, nga e cila të paktën 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimbursohet nga granti pas përfundimit të investimit) dhe 50% kredi afatgjatë për pjesën që duhet të paguhet nga përfituesi.

1. HYRJE

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare për sa i përket punësimit dhe kontributit në PBB dhe konsiderohet si sektor me përparësi nga qeveria shqiptare. Pavarësisht rritjes gjatë kohëve të fundit, bujqësia shqiptare ende përballet me sfida të ndryshme, duke përfshirë vështirësinë në aksesin në kredi; sektori bujqësor ka tërhequr vetëm 2% të totalit të kreditimit të ekonomisë. Sektori i qumështit është një nga sektorët kryesorë agrobiznesorë - rreth 1/2 e fermerëve janë të angazhuar në këtë sektor. Prodhimi i qumështit është rritur gjatë viteve të fundit. Në përgjithësi, prodhimet e bulmetit kanë si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Me gjithë rritjen e vërejtur, bilanci i tregtisë ndërkombëtare së produkteve të bulmetit shënon një deficit strukturor, që nënkupton potencial për rritjen e prodhimit për zëvendësimin e (një pjese të) importeve. Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobiznesi. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: linjë kredish dhe/ose shpërndarja e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vu në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit si edhe tregtarët me shumicë dhe pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillit të BERZH-it për Biznesin e Vogël, i cili ofron konsulencë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Objektivat e studimit

Objekti i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të zinxhirit të përzgjedhur të vlerës në Shqipëri duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialët për investime.

Në mënyrë më specifike, studimi

- ofron një panoramë të përgjithshme të prirjeve kryesore të prodhimit, tendencave të tregtisë ndërkombëtare dhe të tregut;
- ofron një "vështrim të shpejtë" të strukturës së zinxhirit të vlerës, të flukseve dhe administrimit të zinxhirit të vlerës, me fokus të veçantë të "liderët në zinxhirin e vlerës"
- analizon aspekte kryesore të zinxhirit të vlerës nëpërmjet një strategjie bazuar analizën SWOT, dhe
- ofron rekomandime për mundësitë kryesore për sistemin bankar (financim për investime, financim për kapital qarkullues dhe financim të zinxhirit të vlerës).

Ky studim ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes (ndërhyrjeve) për institucionet financiare ose për përgatitjen e produkteve e shërbimeve financiare.

Metodologjia

Për të arritjen e objektivave të studimit janë përdorur të dhëna dhe informacion nga burime dytësore dhe parësore; intervistat gjysmë të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit dhe strategjia bazuar në analizën SWOT. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kornizë e përgjithshme për analizën. Metodologjia përshkruhet më në detaje në seksionin në vijim. Metodologjia përshkruhet më në detaje në seksionin në vijim.

Përdoruesit e synuar

Studimi është hartuar kryesisht për institucionet financiare, por ky raport studimor mund të shërbejë si mbështetje e dobishme në procesin edhe për vendimmarrës të aktorëve të tjerë, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), agjencitë e zhvillimit dhe aktorët e sektorit privat (p.sh. firmat, shoqatat).

Çfarë është dhe çfarë nuk është ky studim

Studimi është një vlerësim i shpejtë dhe, duke marrë në konsideratë burimet dhe kohën e kufizuar në dispozicion, ai trajton në veçanti nevojën për financim në zinxhirin e vlerës dhe për rrjedhojë mundësitë për financime nga bankat. Studimi është projektuar në mënyrë të tillë që është i lehtë për t'u lexuar për sa i përket strukturës/rrjedhës logjike dhe nivelit të hollësive të informacionit, duke iu përshtatur nevojave të vendimmarrësve që e lexojnë (p.sh. bankierët). Studimi është projektuar për të shërbyer si "instrument" për stafin ekzekutiv (të bankave) dhe jo si studim kërkimor në vetvete. Studimi nuk është një studim i plotë i sektorit apo një studim i zinxhirit të vlerës që në mënyrë tipike ofron një analizë të detajuar të aktorëve në zinxhirin e vlerës, të shërbimeve mbështetëse (shërbimet e biznesit, shërbimet bankare dhe shërbime të tjera ose shërbime të lidhura e transaksionet, p.sh., blerësi ofron edhe asistencë e kredi për fermerët) dhe mjedisin ekonomik global, kombëtar dhe lokal.

Struktura e raportit

Raporti është strukturuar si më poshtë: seksioni i dytë (pas hyrjes) përmban përshkrimin e metodologjisë. Seksioni i tretë paraqet një analizë të tendencave të prodhimit dhe të tregtisë ndërkombëtare. Seksioni katërt përshkruan strukturën e zinxhirit të vlerës, flukset dhe profilin e aktorëve. Seksioni pestë jep një panoramë të përgjithshme të proceseve të teknologjisë së prodhimit për ta njohur lexuesin me proceset kryesore teknologjike, duke theksuar kohën kur kryhen këto procese (që shpesh reflektohen në shpenzime), si dhe kohën e prodhimit (si tregues për kohën e shitjeve). Seksioni i gjashtë paraqet strategjinë bazuar në analizën SWOT që fokusohet në nevojat/potencialët për investime, ndërsa seksioni në vijim përmban përfundimet dhe rekomandimet.

2. METODOLOGJIA

Përzgjedhja e sektorit

Studimi për zinxhirin e vlerës së qumështit/produkteve të bulmetit është pjesë e një "pakete studimesh sektoriale" për sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare. Për këtë arsye, faza e parë ka konsistuar në identifikimin e sektorëve prioritarë për të cilat ekziston kërkesa/potenciali më i lartë për rritje dhe investime; kjo është duke marrë në konsideratë potencialin e tregut për eksport ose potencialin për zëvendësimin e importeve. Dy grupe faktorësh janë marrë në konsideratë gjatë identifikimit të produkteve që do të analizoheshin, përkatësisht potenciali i tregut dhe faktorët e tjerë që mundësojnë avantazhe konkurruese të produktit. Potenciali i tregut është shqyrtuar nga dy këndvështrime: potenciali për eksport dhe potencialet për zëvendësimin e importeve. Potenciali për eksport merr në konsideratë performancën e shfaqur të eksporteve (trendin faktik të eksporteve) të kombinuar me kërkesën ndërkombëtare për një produkt të caktuar - kur eksportet rriten në kohë dhe kjo përkon me rritjen e kërkesës ndërkombëtare, konsiderohet se ky produkt ka potenciale për eksport. Potencialet për zëvendësimin e importeve shqyrtojnë potencialet për të përmbushur kërkesën vendase. Aspekte të tjera që çojnë në një avantazh konkurrues përfshijnë faktorin e anës së ofertës, si raporti punë-tokë, tradita dhe aftësitë, si dhe lidhjet e vendosura ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë gjithashtu lidhjet e testuara ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe blerësve ndërkombëtarë.

Zinxhiri i vlerës i produkteve të bulmetit konsiderohet si sektor me përparësi duke marrë në konsideratë potencialin për zëvendësimin e importit.

Mbledhja e të dhënave

Ky studim është pjesërisht cilësor dhe pjesërisht sasior. Kjo mundëson që të kuptohet më mirë statusi dhe dinamikat e zinxhirit të produktit përkatës. Studimi kombinon analizën e të dhënave dytësore dhe të dhënave parësore. Për çështje/tregues të ndryshëm, analiza është bazuar në të dhënat dytësore (duke përfshirë të dhënat sektoriale/strukturore).

Të dhënat dytësore janë marrë nga MBZHR (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), INSTAT (Instituti i Statistikave), UNSTAT COMTRADE (për tregtinë ndërkombëtare), FAOSTAT (për prodhimin dhe konsumin) dhe EUROSTAT (për prodhimin dhe tregtinë ndërkombëtare) etj. Gjithashtu, është kryer një shqyrtim i studimeve dhe raporteve të tjera. Kufizimet e hasura janë se për disa tregues (lidhur me prodhimin vendas dhe tregtinë e brendshme) nuk ka statistika të disponueshme, ndërsa për disa të tjera nuk ka statistika të kohëve të fundit. Megjithatë, për tregtinë ndërkombëtare janë gjetur të dhënat më të fundit që edhe janë analizuar. Ndërkohë, në ato raste kur ka qenë e nevojshme dhe e mundur, janë mbledhur të dhëna nga vende (ose rajone) të tjera për qëllimet e një analize krahasuese.

Mbledhja e të dhënave parësore është realizuar nga intervistat e thelluara gjysmë të strukturuar me persona të mirë informuar kyç që janë aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit. Për të identifikuar aktorët dhe ekspertët kryesorë për çdo zinxhir vlere për intervistat e gjysmë-strukturuar (pjesë e studimit cilësor parësor) u përdor një anketim me teknikë kampionimi "snowball" (ortek bore). Intervistat e thelluara me aktorët kyç të informuar (së bashku me studimet e dokumentacionit në dispozicion) mundësuan të kuptuarin e përditësuar të modeleve kryesore

dhe të hallkave kyçe të zinxhirit të vlerës. Nisur nga burimet dhe koha e kufizuar në dispozicion, u kryen vetëm një numër i kufizuar intervistash.

Analiza e të dhënave

Në lidhje me analizën e të dhënave/informacioneve, të dhënat statistikore dytësore i janë nënshtruar një analize standarde përshkruese, duke përfshirë tabelat dhe grafikët që tregojnë trendet statistikore apo historike. Është kryer edhe krahasimi i trendeve të prodhimit dhe konsumit me ato në botë, në Evropë dhe në disa raste me vendet fqinje, kur kjo ishte e nevojshme. Për sa i përket intervistave me ekspertë/aktorë të ZV-së, shënimet janë analizuar duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kuadër i përgjithshëm për analizën e strukturës së zinxhirit të vlerës (produktet, financat dhe informacionet) dhe për analizën e flukseve.

3. TENDENCAT DHE PERSPEKTIVAT E SEKTORIT TË QUMËSHTIT

3.1. TENDENCAT E PRODHIMIT

3.1.1. Prodhimi parësor

Prodhimi i qumështit dhe produkteve të bulmetit ka pësuar një rënie të madhe gjatë fillimit të tranzicionit pas ristrukturimit të sektorit bujqësor post-komunist. Megjithatë, prodhimi i qumështit nisi të rritet me shpejtësi që në dekadën e parë të tranzicionit - duke u mbështetur kryesisht në fermat e vogla që prodhojnë për konsum vetjak dhe shitje dhe e nxitur nga rritja e kërkesës për konsum në vend.

Rritja e prodhimit të qumështit (dhe produkteve të bulmetit) ka vazhduar edhe përgjatë viteve 2000. Ndërkohë që numri i gjedhëve dhe të imtave është ulur gjatë kësaj periudhe, prodhimi i qumështit është rritur (shih tabelën 1), duke konfirmuar një përmirësim të rendimentit (efiçencës), e mundësuar nga investimet në raca dhe menaxhimi më i mirë që lidhet me një tendencë konsolidimi (për sa i përket përmasës së fermave blegtorale).

Prodhimi i qumështit dominohet kryesisht nga qumështi i lopëve, siç tregohet në tabelën 1 (më poshtë).

Tabela 1: Ecuria e numrit të bagëtive dhe prodhimit të qumështit në periudhën 2000 - 2016

Kategoria	2000	2005	2010	2014	2015	2016
<i>(000 krerë)</i>						
Gjedhë	728	655	493	500	504	492
Dele dhe dhi	3,045	2,701	2,581	2,804	2,850	2,911
<i>(000 ton qumësht)</i>						
Gjedhë	807	930	930	965	964	975
Dele dhe dhi	141	146	140	168	167	170
Totali	948	1,076	1,070	1,133	1,131	1,145

Burimi: INSTAT (2017)

Rajonalizimi

Qarku me nivelin më të lartë të prodhimit të qumështit të lopës është Fieri, që kontribuon me 1/5 e prodhimit total – qarku i Fierit karakterizohet nga ferma me përmasë relativisht të madhe, tokë bujqësore me rendiment të lartë, të cilat krijojnë kushte më të mira për prodhimin e ushqimit për kafshët, ndërsa, nga ana tjetër, disa nga përpunuesit më të mëdhenj të produkteve të bulmetit ndodhen në atë qark (siç tregohet në nënseksionet në vazhdim). Fieri ndiqet nga qarqet e Elbasanit dhe Tiranës, të cilët së bashku përbëjnë rreth 45% të prodhimit total të qumështit të lopës.

Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të qumështit të lopës sipas qarqeve në 2016 (tonë)

Qarku	Gjedhë	Përqindja	Kumulative
Fier	194,837	20,0%	20,0%
Elbasan	121,676	12,5%	32,5%
Tiranë	119,408	12,3%	44,7%
Korçë	89,083	9,1%	53,9%
Shkodër	79,853	8,2%	62,1%
Durrës	68,513	7,0%	69,1%
Dibër	63,222	6,5%	75,6%
Vlorë	59,221	6,1%	81,7%
Lezhë	54,339	5,6%	87,2%
Berat	50,970	5,2%	92,5%
Kukës	50,014	5,1%	97,6%
Gjirokastrë	23,527	2,4%	100,0%
Totali	974,663	100,0%	

Burimi: INSTAT (2017)

Qarqet me përqendrimin më të lartë të prodhimit të qumështit nga të imtat janë Vlora, Gjirokastra, Korça dhe Elbasani, të cilët të gjithë bashkë përbëjnë më shumë se 1/2 e prodhimit total. Në përgjithësi, qarqet që kanë përqendrim më të lartë të të leshtave zakonisht priren të kenë edhe të dhirta, duke qenë se të dy këto lloje janë më të zakonshme për zonat malore.

Tabela 3: Shpërndarja e qumështit të të imtave sipas qarqeve në 2016 (tonë)

Prefektura	Dele	Dhi	Total të imta	Përqindja	Kumulative
Vlorë	17,000	10,000	27,000	15,8%	15,8%
Gjirokastrë	11,651	9,670	21,322	12,5%	28,4%
Korçë	11,776	9,349	21,125	12,4%	40,7%
Elbasan	7,195	12,818	20,013	11,7%	52,5%
Fier	9,219	5,836	15,055	8,8%	61,3%
Berat	6,751	8,171	14,922	8,8%	70,1%
Shkodër	4,904	6,865	11,769	6,9%	77,0%
Dibër	5,439	5,629	11,068	6,5%	83,5%
Tiranë	3,313	5,319	8,632	5,1%	88,5%
Durrës	3,300	3,350	6,650	3,9%	92,4%
Kukës	3,473	3,070	6,543	3,8%	96,3%
Lezhë	1,425	4,911	6,335	3,7%	100,0%
Totali	85,446	84,988	170,434	100,0%	

Burimi: INSTAT (2017)

3.1.2. Përpunimi

Të dhënat e disponueshme (tabela 4) tregojnë një rritje të konsiderueshme në prodhimin e produkteve të bulmetit gjatë periudhës 2000-2005, pasuar me një rënie ose një rritje modeste në vitet në vazhdim (me luhatje nga viti në vit). Në përgjithësi, kërkesa për djathë, kos dhe gjalpë në vend mbulohet kryesisht nga prodhimi vendas. Në përgjithësi, prodhimi i produkteve të bulmetit ka si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Siç u përmend më lart, ka luhatje nga viti në vit dhe nga produkti në produkt, por në të njëjtën kohë janë ngritur shqetësime për besueshmërinë e të dhënave për prodhimin e brendshëm për shkak të nivelit të lartë të informalitetit në përpunimin e produkteve të bulmetit (njësoj si në të gjithë sektorin agrourbues).

Tabela 4: Ecuria e prodhimit të djathit dhe gjalpës (tonë)

Kategoria	2000	2005	2010	2016
Djathë	8,404	13,947	13,527	14,301
Gjalpë	440	647	680	824

Burimi: INSTAT (2017)

Produkti kryesor i bulmetit është djathi. Rreth 3/4 e prodhimit total të djathit bazohet në qumështin e lopës - pjesa tjetër në qumështin e të imtave, kryesisht të deles. Lloji kryesor i djathit është djathi i butë (i bardhë si djathi feta) - ky lloj djathi konsumohet gjerësisht, por edhe preferohet nga përpunuesit për shkak të kthimit të shpejtë të investimit (shpesh djathi i butë (bardhë) ruhet/stazhionohet për disa javë krahasuar me djathin e fortë të quajtur "kaçkavall" dhe djathi "vize", që stazhionohet për disa muaj, gjë e cila përbën një kufizim likuiditeti) - djathi i fortë ka më tepër gjasa të prodhohet gjatë muajve me prodhimtari më të lartë qumështi.

Nuk ka të dhëna ose statistika për përqindjen e produkteve të bulmetit që prodhohen duke përdorur (pjesërisht ose plotësisht) qumësht pluhur, ndonëse janë raportuar raste të përdorimit të konsiderueshëm të qumështit pluhur. Etiketat e produkteve të bulmetit nuk tregojnë nëse është përdorur qumësht pluhur - kjo gjë përbën një shqetësim edhe për konsumatorët (shihni seksionin në vijim në lidhje me tregun dhe preferencat e konsumatorëve).

Tabela 5: Prodhimi i produkteve të bulmetit sipas llojit (2016)

Produktet e bulmetit	Tonë
Qumësht për konsum final	10,983
Qumësht i papërpunuar	533
Qumësht i paskremuar	6,425
I pasterizuar	6,242
UHT	182
Qumësht gjysmë i skremuar	3,950
I pasterizuar	2,967
UHT	983
Qumësht i skremuar	74
I pasterizuar	74
Ajkë/mazë	184
Me përmbajtje yndyre sipas peshës deri në 29%	100
Me përmbajtje yndyre sipas peshës mbi 29%	84
Kos, kos i lëngshëm dhe të tjera	15,687
Gjalpë dhe produkte të tjera bulmeti me yndyrë të verdhë	824
Djathë	14,301
Sipas llojit të qumështit	
Djathë lope	10,516
Djathë deleje	2,647
Djathë dhie	1,139
Sipas strukturës	
Djathë i butë	8,101
Djathë me fortësi mesatare	4,334
Djathë i fortë	533
Djathë i freskët (gjizë etj.)	1,334

Burimi: INSTAT (2017)

3.2. TENDENCAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Bilanci tregtar i produkteve të bulmetit tregon një deficit strukturor, por shumë më të ulët nëse krahasohet me nënsektorin tjetër të blegtorisë - atë të mishit. Për shkak të kushteve të tregut dhe kufizimeve në prodhim (kostot e ushqimit për kafshët në Shqipëri janë më të larta se në vendet e tjera të rajonit, kryesisht për shkak të përmasës së vogël të fermave), deficitin tregtar i produkteve të bulmetit duhet të konsiderohet si strukturor dhe pritet që të vazhdojë kështu edhe në të ardhmen. Eksportet janë të papërfillshme për shkak të kufizimeve në standarde dhe për shkak të kufizimeve strukturore (të shpjeguara më lart).

Importet e produkteve të bulmetit përbëhen kryesisht nga djathi dhe qumështi UHT. Një produkt tjetër bulmeti që importohet është qumështi pluhur, deri në rreth 500 tonë/vit ose rreth 1 milionë USD - siç përmendet pak më lart, ai përdoret në agroindustri (shpesh përzihet me qumësht të freskët) për të prodhuar produkte bulmeti, pjesërisht për të përballuar kostot e qumështit të freskët dhe pjesërisht për të mbuluar mungesat/hendekut ndërmjet sezonalitetit të kërkesës nga njëra anë dhe të ofertës së qumështit të freskët (të papërpunuar) në anën tjetër.

Tabela 6: Tregtia e jashtme e Shqipërisë në produkte bulmeti (HS 04)

Viti	Eksporte Milion USD	Importe Milion USD	Eksport/ Import
2000	0,20	5,00	4,0%
2005	0,57	12,57	4,5%
2010	2,98	20,40	14,6%
2015	1,93	22,02	8,8%
2016	1,37	20,71	6,6%

Burimi: INSTAT (2017)

Eksportet e djathit janë të papërfillshme apo shumë të ulëta. Nga ana tjetër, gjatë dy viteve të fundit, është vërejtur një rritje e sasisë të djathit të importuar.

Tabela 7: Importi dhe eksporti i djathit, Shqipëri, sipas vitit

Viti	Eksporte		Importe		Eksport/ Import
	000 USD	Tonë	000 USD	Tonë	Vlera
2000	:	:	1,417	669	:
2005	:	:	4,273	1,550	:
2010	15	3	5,585	1,294	0%
2014	2	0	5,153	978	0%
2015	54	10	6,105	1,445	1%
2016	171	34	8,236	2,091	2%

Burimi: UNSTAT (2018)

Partneri kryesor i eksportit është Kosova, megjithatë, eksportet janë të papërfillshme (nën 200 000 USD). Furnizuesi kryesor i djathit të importuar është Gjermania, me 44% të totalit të importit, e ndjekur nga Italia dhe Austria, të cilat të gjitha së bashku përbëjnë 2/3 e totalit të importeve.

Tabela 8: Importi i djathit dhe gjizës, Shqipëri, sipas shtetit partner kryesor, në 2016

Shteti	000 USD	Tonë	Përqindja (tonë)
Totali	8,236	2,091	100%
Gjermani	2,978	910	44%
Itali	2,741	436	21%
Austria	1,029	256	12%

Burimi: UNSTAT (2018)

3.3. TREGU

3.3.1. Tregu ndërkombëtar


Prodhimi ndërkombëtar dhe tendencat e tregtisë, me fokus në BE¹

Prodhimi dhe konsumi i produkteve të bulmetit është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së fundit në të gjithë botën - vendet aziatike janë nxitësit kryesorë të kësaj rritjeje. Kërkesa në rritje në botë dhe në BE pritet që të mbështesë rritjen e kërkesës në tregjet botërore të produkteve të bulmetit në afat e gjatë. Megjithatë, pritet që të vazhdojë luhatja e çmimeve në tregjet botërore, gjë e cila mund të nënkuptojë presion për çmime më të ulëta dhe që sjell implikime për prodhuesit me efikasitet më të ulët apo kosto më të larta, siç janë në mënyrë tipike prodhuesit e produkteve blegtorale të bulmetit në Shqipëri (si në drejtim të konkurrencës me çmimet e lira të produkteve të bulmetit nga importet, ashtu edhe të eksporteve të mundshme, ndonëse këto të fundit nuk duken të realizueshme në të ardhmen e afërt). Një strategji për t'u përballur me presionin e çmimeve të tregut është prodhimi i produkteve me vlerë të shtuar më të lartë, si p.sh. EOM/TGJM (PDO/PGI) për djathin.

Prodhimi dhe tregtimi i produkteve të bulmetit në botë pritet që të rritet. Kina është importuesi më i madh në botë i produkteve të bulmetit dhe parashikohet që ajo të rrisë ndjeshëm importet e saj - diçka e ngjashme pritet edhe për vendet e tjera aziatike.

BE-ja është eksportues neto – parashikohet që ajo të plotësojë deri në 30% të rritjes globale të kërkesës për import. Ndërkohë, importet e produkteve të bulmetit në BE janë shumë të ulëta në sajë të konkurrueshmërisë së lartë të prodhuesve lokalë në BE dhe për shkak të kërkesave për standarde të vendosura nga tregu i BE-së – për të dyja këto arsye, Shqipëria nuk mund të eksportojë sasi të mëdha produktesh bulmeti në të ardhmen (deri më tani ajo nuk mund të eksportojë fare për në BE për shkak të ndalimit lidhur me standardet).

Figura 1: Tregtia e djathit në BE-27 (000 tonë)



Burimi: EC (2017)

1 Bazuar pjesërisht te "EC (2017). EU Agricultural Outlook for the Agricultural Markets and Income 2017-2030"

Siç u përmend më lart, Shqipëria nuk ka avantazhe konkurruese në eksportimin e produkteve të bulmetit drejt shteteve të BE-së apo drejt vendeve të rajonit, të paktën në një periudhë afatmesme. Përpjekjet e kohëve të fundit për të eksportuar qumësht të teknologjisë UHT në vendet fqinje kanë hasur në sfida që lidhen gjithashtu me sistemin e sigurisë ushqimore. Shqipëria përballet edhe me konkurrencë të lartë nga vende të tjera jo-BE në rajon, si p.sh. Serbia, e cila është më konkurruese në prodhimin e ushqimit për kafshët (i cili është faktor kyç përcaktues në kostot e prodhimit të qumështit dhe si edhe mishit).

Potenciali për eksport drejt Kosovës është shfrytëzuar nga disa kompani të përpunimit të qumështit. Potenciali për eksport mund të eksplorohet edhe drejt vendeve të tjera (siç është treguar nga një prej prodhuesve lider të produkteve të bulmetit në Shqipëri (Gjirofarm), e cila ka eksportuar drejt Kosovës, SHBA-së dhe Azisë). Thënë kjo, kufizimi kryesor për prodhuesit shqiptarë është fakti që këto tregje kërkojnë në mënyrë tipike vëllime të mëdha. Duke pasur parasysh mungesën e konkurrueshmërisë për të prodhuar ose eksportuar në vëllime të mëdha, një strategji që mund të jetë efektive për prodhuesit shqiptarë mund të jetë që të prodhojnë djathë EOM/TGJM të cilësisë së lartë, i cili mund të jetë konkurrues në tregun shqiptar, por që mund të synojë edhe tregjet e eksportit, veçanërisht diasporën.

3.3.2. Tregu i brendshëm

Furnizimi i tregut

Faktori kryesor nxitës i rritjes (modeste) të prodhimit të produkteve të bulmetit ka qenë rritja e kërkesës në tregun e brendshëm. Pjesa e qumështit të importuar ndaj konsumit (ose oferta që përdoret si tregues i përafërt për konsumin) është më e ulët se 1%, ndërsa eksportet janë të papërfillshme.

Tabela 9: Oferta e qumështit- HS 0401 (000 tonë)

Kategoria	2000	2005	2010	2014	2015	2016
Prodhimi	948	1,076	1,070	1,133	1,131	1,145
Importi	1.4	2.9	7.4	6.1	7.1	7.1
Eksporti	0.5	:	:	:	:	0.05
Oferta	948.9	1,079	1,077	:	1,138	1,152
Importi/ofertë	0.1%	0.3%	0.7%	:	0.6%	0.6%
Eksporti/prodhimi	0.05%	:	:	:	:	0.004%

Burimi: FAOSTAT (2018) dhe INSTAT (2017 për prodhimin) dhe UNSTAT (2018) për tregtinë

Edhe oferta e brendshme e produkteve të bulmetit dominohet nga prodhimi vendas - në rastin e djathit, përqindja e importit ka qenë më e ulët se 10% në të shkuarën, megjithatë, gjatë viteve të fundit është vënë re një rritje e vëllimeve të importuara - në vitin 2016 përqindja e djathit të importuar ndaj ofertës së tregut të brendshëm ishte afërsisht 13%. Djathi i importuar ndahet në dy lloje: djathë me çmim të ulët (zakonisht i butë) dhe djathë me cilësi dhe çmim të lartë (p.sh., llojet që nuk prodhohen nga prodhuesit lokalë në Shqipëri).

Tabela 10: Oferta e djathit– HS 0406 (djathë dhe gjizë) (000 tonë)

Kategoria	2000	2005	2010	2016
Prodhimi	10,6	14,5	15,9	14,3
Importi	0,7	1,5	1,3	2,1
Eksporti	:	:	0,003	0,034
Oferta	11,3	16,0	17,2	16,4
Importi/ofertë	6,2%	9,4%	7,6%	13%
Eksporti/prodhimi	:	:	0,02%	0,24%

Burimi: FAOSTAT (2018) dhe INSTAT (2017 për prodhimin) dhe UNSTAT (2018) për tregtinë

Kërkesat dhe preferencat e konsumatorit

Djathi është produkti kryesor i bulmetit dhe një nga artikujt ushqimorë bazë tëshportës së konsumatorit shqiptar. Një nga faktorët më të rëndësishëm që lidhet me preferencat e konsumatorit është lloji i qumështit që përdoret për të bërë djathin. Natyrisht që shumica e konsumatorëve preferojnë djathin e bërë pa qumësht pluhur, por që prodhohet vetëm me qumësht të freskët të papërpunuar. Përdorimi i qumështit pluhur perceptohet si një metodë jonaturale dhe jotradicionale për prodhimin e djathit².

Edhe origjina e prodhimit duket se është një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqiptarë. Sipas studimeve të ndryshme, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre nga origjina (vendase kundrejt importeve). Përgjithësisht, ka një preferencë të madhe të konsumatorëve për produktet ushqimore vendase. Gjithashtu, brenda grupit të produkteve vendase, ka dallime të konsiderueshme në perceptimet bazuar në rajonin e prodhimit brenda Shqipërisë. Shumica e konsumatorëve e konsiderojnë rajonin/zonën e origjinës si të rëndësishme ose si shumë të rëndësishme kur vendosin të blejnë produkte shqiptare, duke përfshirë produktet e bulmetit dhe veçanërisht djathin. Konsumatorët shqiptarë në zonat urbane tregojnë një preferencë të fortë për djathin e Gjirokastrës. Gjithashtu, shumica e konsumatorëve janë të gatshëm të paguajnë një çmim më të shtrenjtë për djathin e prodhuar në rajonin e preferuar. Preferenca e konsumatorëve për djathin nga Gjirokastra (ose rajonet e tjera), e cila ka një traditë të madhe dhe histori të gjatë në prodhimin e djathit, përbën një potencial për të zhvilluar markat rajonale, duke përfshirë TGJM ose EOM (PDO/PGI)³⁴.

Konsumi i dukshëm i djathit në Shqipëri është më i ulët se konsumi mesatar për frymë në Evropë, i cili në vitin 2013 ishte rreth 13,8 kg/frymë, ndërsa në Shqipëri ishte 6,3 kg/frymë. Mali i Zi ka konsumin më të lartë të djathit për frymë nga të gjitha vendet e Ballkanit, ndërsa Serbia ka konsumin më të ulët për frymë.

2 Imami, D., Zhllima, E., Merkaç, E., Chan-Halbrendt, C., & Canavari, M. (2016). Albanian Consumer Preferences for the use of Powder Milk in Cheese-Making: A Conjoint Choice Experiment. *Agricultural Economics Review*, 17(1), 20.

3 Imami, D., Engjell, S., Maurizio, C., Catherine, C., & Alban, C. (2016). Analysis of consumers' preferences for typical local cheese in Albania applying conjoint analysis. *New Medit*, 15(3), 49-55.

4 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

Tabela 11: Konsumi i përafërt i djathit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë)

Shteti	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Shqipëri	3,4	5,0	5,5	5,9	5,9	6,3
Mali i Zi	:	:	16,3	16,7	17,1	17,2
Serbi	:	:	2,2	2,2	2,7	2,8
Maqedoni	1,9	3,7	4,6	4,6	4,5	4,6
BE	15,0	16,0	17,0	17,0	17,2	17,2
Evropë	11,2	12,7	13,7	13,7	13,8	13,8
Evropa Lindore	4,6	6,8	7,8	7,7	7,7	7,9
Evropa Jugore	13,7	14,2	15,6	15,6	15,6	15,2
Evropa Perëndimore	20,1	20,8	21,7	21,9	21,8	21,8

Burimi: FAOSTAT (2018)

Shënim: të dhënat e disponueshme në FAOSTAT për konsumin mbulojnë periudhën deri në vitin 2013 - ndonëse këto të dhëna nuk janë përditësuar, ato shërbejnë si informacion i dobishëm për tendencat e konsumatorit, të cilat priren të ndryshojnë ngadalë përgjatë viteve.

Standardet e sigurisë

Në të gjithë pjesën e poshtme të zinxhirit të vlerës ka mangësi të standardeve të sigurisë ushqimore. Shqipëria përballlet me probleme serioze në sistemin kombëtar të kontrollit të sigurisë ushqimore për sa i përket legjislacionit, infrastrukturës, kapaciteteve institucionale, kontrollit dhe zbatimit të ligjit, të cilat ndikojnë në rreziqet reale dhe të perceptuara të sigurisë për konsumatorët. Problemet në sistemin e sigurisë ushqimore janë identifikuar nga disa studime⁵. Standardi i sigurisë ushqimore është një shqetësim kryesor i perceptuar nga konsumatorët shqiptarë. Studime të shumta^{6,7} dokumentojnë/theksojnë shqetësimet e konsumatorëve për sigurinë ushqimore.

Qeveria shqiptare e konsideron sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit si prioritet në politikat e saj në axhendën e përafrimit drejt BE-së. Ligji kryesor për sigurinë ushqimore në Shqipëri është ligji "Për ushqimin", nr. 9863⁸, (datë 28.01.2008). Ai përcakton kërkesat për prodhimin dhe hedhjen në treg të produkteve të sigurta ushqimore për njerëzit dhe të ushqimit për kafshët, deri diku në përputhje me dispozitat e BE-së.

MBZHR ka përcaktuar Standardet Minimale Kombëtare (SMK) në përputhje me praktikën e BE-së. Praktika e mirë bujqësore (PMB) duhet të përkojë me llojin e kultivimit që një fermer duhet të ndjekë në rajonin përkatës, duke përfshirë minimalisht pajtueshmërinë me kërkesat e përgjithshme ligjore për mjedisin. Gjatë viteve të fundit, siguria ushqimore, mirëqenia e kafshëve dhe SMK-të janë rishikuar nëpërmjet ndryshimeve ligjore dhe ligjeve të reja, si edhe nëpërmjet Urdhrave të

5 Verçuni, A., Zhllima, E., Imami, D., Bijo, B., Hamiti, X., & Bicoku, Y. (2016). Analysis of consumer awareness and perceptions about food safety in Tirana, Albania. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*, 15(1), 19.

6 Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., & Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 14(3).

7 Zhllima, E., Imami, D., & Canavari, M. (2015). Consumer perceptions of food safety risk: Evidence from a segmentation study in Albania. *Journal of Integrative Agriculture*, 14(6), 1142-1152.

8 I gjithë legjislacioni shqiptar (në shqip) mund të gjendet në <http://ligjet.org>.

Ministrit të Bujqësisë për këto çështje, siç janë identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve dhe fermave, licencimi i biznesit, grumbullimi dhe transporti i qumështit, shëndeti i kafshëve, etj. Pajtueshmëria me SMK-të është gjithashtu një kërkesë për të pasur akses në disa grante mbështetëse, kryesisht në ato nga IPARD II.

Pavarësisht ndryshimeve ligjore dhe institucionale, shumë fermerë nuk janë të informuar ose të ndërgjegjësuar në lidhje me standardet. Sipas një studimi të mëparshëm⁹, rreth 87% e fermerëve të gjedhëve për qumësht të anketuar deklarojnë se ata nuk kanë depozita (tank) ftohëse për ruajtjen e qumështit, gjë e cila është një kusht paraprak për të arritur sigurinë e qumështit dhe standardet e cilësisë. Shumica e fermerëve nuk e dinë se cilat institucione janë përgjegjëse për sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve ose kontrollin e vazhdueshëm të standardeve. Megjithatë shumica e fermerëve deklarojnë se kanë një regjistër të kafshëve (gjësë së gjallë) në fermë, ata nuk e dinë se cili është institucioni përgjegjës për kontrollin e tyre. Mungesa e ndërgjegjësimit për standardet çon në papajtueshmëri me këto standarde, gjë që nënkupton akses më të ulët në treg (veçanërisht në rastin e eksporteve) dhe kufizime në aksesin në fonde, ku aksesin në këto fonde kushtëzohet nga përmbushja e disa standardeve në mënyrë të dokumentuar (p.sh. IPARD II).

Presioni në rritje nga përafrimi me legjislacionin e BE-së për të përmirësuar standardet, nënkupton kërkesë në rritje për investime të konsiderueshme përgjatë zinxhirit të vlerës për të përmbushur standardet. Fushatat e ndërgjegjësimit të kombinuara me përpjekjet për një zbatim më rigoroz të ligjit dhe disponueshmëria e stimujve financiarë do të rriste shumë gjasat për t'i rritur këto investime në nivel ferme, tregtari dhe përpunuesi.


9 Gjeci, G., Bicoku, Y., & Imami, D., (2016). Awareness about food safety and animal health standards – the case of dairy cattle in Albania. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*. 22(2), 339–345.

4. STRUKTURA E ZINXHIRT TË VLERËS DHE AKTORËT KRYESORË

4.1. STRUKTURA E ZINXHIRT TË VLERËS DHE PROFILI I AKTORËVE

Figura 2 në vijim identifikon në formë skematike aktorët e zinxhirit të vlerës së qumështit dhe kanalet kryesore përmes të cilëve qumështi qarkullon nga fermerët te konsumatori fundor.

Figura 2. Skema e zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit



Burimi: Përgatitur nga vetë autorët

Siç mund të vërehet në figurë, aktorët kryesorë në zinxhirin e vlerës së qumështit janë fermerët, grumbulluesit e qumështit, përpunuesit e qumështit dhe shitësit me shumicë dhe pakicë të produkteve të bulmetit. Në fillim në kemi paraqitur një profil të shkurtër të aktorëve kryesorë në zinxhirin e vlerës dhe më pas vazhdojmë me përshkrimin e flukseve në zinxhirin e vlerës dhe koordinimin e këtij zinxhiri.

Fermerët

Shumica e njësive prodhuese të qumështit nga lopët janë shumë të vogla, me vetëm 1 lopë për fermë, kryesisht e orientuar drejt përmbushjes së nevojave për konsum vetjak. Përkatësisht, 59% e fermave me gjedhë për qumësht kanë vetëm 1 lopë. Rreth 1/3 e fermave me gjedhë për qumësht kanë 2-3 lopë dhe mund të konsiderohen si ferma që prodhojnë për konsum vetjak dhe për të shitur, duke qenë se fermat që kanë 2-3 lopë zakonisht shesin një pjesë të qumështit. Rreth 8%, ose pothuajse 13 000 ferma, kanë 5 ose më shumë gjedhë - këto ferma janë me orientim tregu, mes të cilave janë 1748 ferma, ose 1% e tyre, me 11 lopë ose më shumë, të cilat kanë një orientim më të fortë drejt tregut dhe një potencial më të fortë për investime në të ardhmen (tabela 12).

Tabela 12: Shpërndarja e fermave me gjedhë për qumësht sipas përmasës

	Numri i fermave	% ndaj totalit
Numri i fermave		
Kategoria sipas përmasës		
1 kre	94,481	59,2
2 deri në 3 krerë	52,155	32,7
4 deri në 5 krerë	7,756	4,9
6 deri në 10 krerë	3,328	2,1
Mbi 11 krerë	1,748	1,1
Totali	159,468	100,0
Numri i krerëve		
Kategoria sipas përmasës		
1 kre	94,481	28,8
2 deri në 3 krerë	115,869	35,3
4 deri në 5 krerë	33,273	10,1
6 deri në 10 krerë	24,287	7,4
Mbi 11 krerë	60,187	18,3
Totali	328,097	100

Burimi: INSTAT (2017 - të dhënat e publikuara nga censusi i bujqësisë)

Tabela 13 në vijim paraqet fermat më të mëdha me gjedhë për qumësht - përkatësisht ato me 21-50 lopë dhe ato me mbi 50 krerë, të cilat mund të konsiderohen ferma të mëdha në kontekstin shqiptar.

Tabela 13: Shpërndarja e fermave të mëdha me gjedhë për qumësht sipas përmasës

Lopët	Numri
21 deri në 50 krerë	213
Mbi 50 krerë (51 e lart)	58
Totali i fermave me lopë me mbi 21 lopë	281

Burimi: Të dhëna të MBZHR-së të përpunuara nga autorët.

Për sa i përket shpërndarjes në nivel qarku, fermat me orientim tregu gjenden kryesisht në zonat e ulëta dhe perëndimore të Shqipërisë, përkatësisht në Fier, Shkodër, Vlorë dhe Durrës, ku ka edhe një përqendrim përgjithësisht më të madh të të gjitha llojeve të fermave me gjedhë për qumësht.

Lopët e qumështit mbahen normalisht në stalla të thjeshta, ushqehen kryesisht me foragjere dhe kulloten në fusha me barë dhe livadhe dhe u jepet edhe ushqim i koncentruar kafshësh dhe minerale. Në vetëm pak raste, fermat e mëdha kanë investuar në stalla bashkëkohore dhe kanë nisur të zbatojnë kryesisht një regjim të qëndrueshëm prodhimi.

Fermat e vogla të lopëve zakonisht i mjelin lopët me dorë, ndërsa ato më të mëdhatë kanë pajisje për mjelje.

Shumica e njësive prodhuese të qumështit të deleve dhe dhive janë gjithashtu shumë të vogla; përmasa mesatare e tufës së deleve është pak më pak se 30 dhe përmasa mesatare e tufës së dhive është afërsisht 25 dhi.

Ka rreth 40 000 fermerë që kanë dele dhe 22 000 që kanë dhi. Shumica e tufave të të imtave janë të përziera (duke kombinuar të dy llojet). Shumica e fermave me të imta kanë deri në 10 krerë. Vetëm 43% e fermerëve që kanë dele dhe 33% e fermerëve që kanë dhi kanë më shumë se 10 krerë. Në shumicën e rasteve, të imtat rriten në kullota - megjithatë, së fundmi janë vënë re raste të mbarështimit intensiv për disa ferma më të mëdha me dhi.

Tabela 14: Shpërndarja e fermave të të imtave sipas përmasës

Përmasa	Dele	% e totalit	Dhi	% e totalit
Numri i fermave				
Totali	39,532	100	21,738	100
1	2,065	5	3,717	17
2-3	6,866	17	5,532	25
4-5	5,845	15	2,375	11
6-10	7,912	20	2,845	13
11 e lart	16,844	43	7,269	33
Numri i krerëve				
Totali	1,179,540	100	496,102	100
1	2,065	0	3,717	1
2-3	16,580	1	12,873	3
4-5	27,163	2	10,837	2
6-10	65,677	6	23,279	5
11 e lart	1,068,055	91	445,396	90

Burimi: INSTAT (2017 - të dhënat e publikuara nga censusi i bujqësisë)

Vetëm 5000 (5% e të gjitha fermave me të imta për prodhimin e qumështit) ferma janë ferma të konsideruara të mëdha e komerciale (Tabela 15); këto ferma mund të ishin me interes për sistemin bankar. Vlera modale për fermat e mëdha komerciale duket të jetë mes 101 dhe 200 krerë.

Tabela 15: Fermat me orientim tregu të të imtave (dele dhe dhi), për 2017

Kategoritë sipas përmasës	Numri	%
51 deri në 100 krerë	546	10,9
101 deri në 200 krerë	2704	54,0
201 deri në 300 krerë	1506	30,1
Mbi 300 krerë	251	5,0
Totali i fermave të deleve dhe dhive	5007	100,0

Burimi: Të dhënat nga MBZHR të përpunuara nga autorët.

Është e qartë se shumica e tufave janë të vogla. Ka disa arsye për mbizotërimin e tufave të vogla dhe në uljen e numrit të të imtave , përfshirë:

- Vështirësia për të gjetur ushqim, veçanërisht gjatë dimrit;
- Mungesa e kapaciteteve për grumbullimin/përpunimin e qumështit. Kjo është më e dukshme në qarkun e Kukësit, ku, pavarësisht sipërfaqes së madhe të kullotave/lëndinave, tufat janë të vogla dhe prodhimi është i ulët;
- Problemet e pronësisë mbi kullotat;
- Mungesa e fuqisë punëtore; të rinjtë kanë emigruar ose nuk duan të punojnë në blegtori;
- Mbarështuesit e të imtave janë kryesisht individë të moshës së mesme ose të moshuar;
- Mungesa e burimeve financiare për të blerë kafshë, ushqim për kafshët, etj., në të gjitha qarqet.

Për sa i përket shpërndarjes në nivel qarku, fermat me orientim tregu të deleve dhe dhive gjenden kryesisht në zonat malore të Shqipërisë, përkatësisht në Gjirokastrë, Vlorë, Berat dhe Korçë.

Sistemi i prodhimit është zakonisht i bazuar në kullota. Delet dhe dhitë varen pothuajse plotësisht nga kullotja për t'u ushqyer; ato mbahen kryesisht në kullota, si në dimër, ashtu edhe në verë. Në verë ata përdorin edhe tokën bujqësore pas korrjes.

Fermat me të imta në Shqipëri operojnë pothuajse vetëm me teknologjinë e mjeljes me dorë, gjë e cila kërkon shumë punë. Delet dhe dhitë milen dy herë në ditë dhe qumështi ruhet duke përdorur disa mënyra: mbahet i freskët në ujë të rrjedhshëm të ftohtë; mbahet i freskët nëpërmjet shisheve plastike të mbushura me akull, të cilat vendosen në kazanët e qumështit dhe në raste të veçanta edhe në depozita (tank) ftohëse. Freskimi në sistemin me ujë të ftohtë përdoret vetëm në zonat malore që kanë një furnizim të qëndrueshëm me ujë. Fermerët janë më të interesuar në depozitat ftohëse, sepse ato ofrojnë mundësinë e ftohjes së qumështit gjatë natës që pastaj t'u dorëzohet përpunuesve në mëngjes, megjithatë problem mbetet aksesin në energji në zona/kullota malore.

Fermat më të mëdha të të imtave kanë investuar në përmirësimin e stallave dhe shumë prej tyre e prodhojnë vetë ushqimin për kafshët duke kultivuar foragjere dhe drithëra.

Megjithatë, intensiteti i ulët i përdorimit të kapitalit për prodhim si për fermat e lopëve edhe të të imtave ka rezultuar në prodhimtari të ulët, kosto relativisht të larta prodhimi dhe fitim të ulët, të cilat nuk mundësojnë grumbullimin e kapitalit për investime të reja duke bërë kështu që niveli i prodhimit dhe rendimenti në shumë ferma blegtorale të jetë i ulët.

Grumbulluesit e qumështit

Grumbullimi dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Grumbullimi i qumështit të papërpunuar organizohet kryesisht nga përpunuesit e qumështit dhe grumbulluesit privatë të qumështit. Edhe fermerët dorëzojnë sasi të konsiderueshme qumështi për përpunim tek njësitë përpunuese¹⁰.

Ndërkohë që përpunuesit e qumështit zakonisht grumbullojnë qumësht kryesisht nga zona ku ndodhet njësia përpunuese, grumbulluesit e pavarur të specializuar grumbullojnë qumësht edhe nga zona më të largëta. Fermerët e vegjël zakonisht nuk kanë asnjë pajisje për ftohjen e qumështit (tank ftohës), kështu që grumbullimi bëhet të paktën një herë në ditë, dhe nga muaji maj deri në shtator mund të bëhet edhe dy herë në ditë. Një grumbullues privat i pavarur i qumështit zakonisht grumbullon qumësht nga 50 deri në 150 ferma (afërsisht 500 deri në 1500 litra në ditë). Ata fitojnë rreth 2-7 Lekë për litër qumësht për shërbimin e grumbullimit, në varësi të distancës së përshkuar për grumbullimin; kjo është në rastin kur ata veprojnë si sipërmarrës të pavarur - megjithatë shpesh, veçanërisht në rastin e disa përpunuesve më të mëdhenj të qumështit, grumbulluesit mund të jenë punonjës të kompanisë.

Qumështi i mbrëmjes dhe i mëngjesit shpesh përzihet në fuçi ose bidonë plastike, shpesh në temperaturë të lartë dhe për një kohë të gjatë. Gjithashtu, qumështi i cilësive të ndryshme përzihet dhe transportohet në të njëjtën ngarkesë. Pastrimi dhe dezinfektimi i enëve të qumështit shpesh është i papërshtatshëm. Në zonat malore, koha që nevojitet për të grumbulluar dhe transportuar qumështin është edhe më e gjatë (deri në katër orë pa ftohje). Kontejnerët (kovat) e qumështit më së shumti nuk janë prej plastike për mbajtjen e ushqimeve ose materiale inoksi dhe shumica e qumështit nuk ruhet apo transportohet në temperaturën e kërkuar.

Përpunuesit e qumështit

Qumështi i deles dhe dhisë përpunohet pothuajse vetëm për të prodhuar djathë. Qumështi që u dorëzohet përpunuesve të qumështit përpunohet në mënyra të ndryshme bazuar tek tradita, përvoja dhe njohuritë. Qarqet si Korça, Gjirokastra, Saranda dhe Vlora janë qarqe tradicionale për përpunimin e qumështit të deles dhe dhisë dhe kanë më shumë përvojë dhe njohuri për të prodhuar djathë të fortë (djathë i verdhë i njohur edhe si djathë kaçkavall dhe vize) dhe djathë të bardhë me shëllirë (djathë i llojit Feta). Prodhuesit e djathit ia kanë kaluar njohuritë për prodhimin e djathit brezit të ri të familjes së tyre, duke e bërë më të lehtë gjetjen e personave që kanë njohuri të thella për prodhimin tradicional të djathit. Situata është krejt ndryshe në zona të tjera si Dibra, Kukësi ose Shkodra. Ndryshimet me këto zona mund të shikohen jo vetëm në sasinë e djathit të prodhuar, por edhe në cilësinë e tij, veçanërisht për djathin e fortë dhe djathin e tipit Feta që prodhohet nga qumështi i deles ose nga përzierja e qumështit të deles me atë të dhisë. Djathi që shitet në treg është i ndryshëm në shije, përbërje dhe parametra të tjerë fizikë (kimikë).

Furnizimi i qumështit nga fermat përbën problemin kryesor për industrinë e përpunimit të qumështit. Furnizimi nga fermerët ka standarde të ulëta të sigurisë ushqimore dhe shpesh kosto të larta grumbullimi, megjithëse kjo ndryshon nga qarku në qark. Në disa zona, çmimi i lartë i qumështit kombinuar me sasinë e ulët të tij rezulton në fitim të ulët për biznesin. Rritja e

¹⁰ FAO (2014). Studim për sektorin e qumështit

sasisë dhe cilësisë së prodhimit të qumështit është baza për zhvillimin e një industrie bulmeti bashkëkohore. Furnizimi i mjaftueshëm me qumësht për fabrikat e përpunimit është i rëndësishëm për shfrytëzimin e kapacitetit të pajisjeve dhe shpërndarjen e kostove fikse përmes një prodhimi më të lartë.

Teknologjia e përpunimit në këtë fushë karakterizohet nga dy lloje njësisish përpunimi, përkatësisht njësitë sezonale të përpunimit të përpunimit dhe ato që operojnë gjithë vitit që mund të jenë më të mëdha dhe më të mekanizuara. Njësitë sezonale të përpunimit janë mjaft të zakonshme veçanërisht në rastin e përpunimit të qumështit nga të imtat. Industria e bulmetit vuan nga fragmentarizimi, cilësia e dobët e lëndës së parë dhe praktikant e dobëta të përpunimit, sidomos në rastin e kompanive të vogla dhe të mesme. Shumë punishte për prodhimin e djathit nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për ruajtje dhe zakonisht qumështi përpunohet duke përdorur një teknologji primitive.

Periodha e shkurtër gjatë së cilës qumështi i deleve dhe dhive është i disponueshëm (100-150 ditë në vit) kërkon tufa relativisht të mëdha për furnizimin me qumësht; në të kundërt, kostoja e grumbullimit të qumështit mund të jetë e lartë dhe kontrolli i cilësisë së qumështit i vështirë. Në këto kushte, njësitë e vogla përpunuese (deri në 5 tonë/ditë) që ndodhen në zonën e prodhimit duken më të përshtatshme; në një situatë tipike një njësi e tillë mbulon rreth 150 tufa me nga 50 dele/dhi (rreth 5 fshatra).

Përpunuesit e vegjël vuajnë nga mungesa e njohurive të mjaftueshme për procesin teknologjik, gjë që çon në standarde dhe cilësi të ulët dhe produkt jo të besueshme të djathit (cilësi të ndryshme në kohë). Sipas studimit ka një kërkesë apo nevojë për ekspertizë dhe edukim në lidhje me procesin teknologjik të përpunimit të qumështit.

4.2. FLUKSET NË ZINXHIRIN E VLERËS DHE KOORDINIMI I ZINXHIRIT

Flukset e produktit, të informacionit dhe ato financiare

Flukset e produktit. Siç tregohet në mënyrë skematike në figurën 2, ekzistojnë katër kanale nëpërmjet të cilëve qumështi (dhe qumështi i përpunuar) qarkullon nga fermerët deri te konsumatorët, përkatësisht (i) kanali i shitjes informale direkte të qumështit, (ii) kanali i pintegruar, (iii) kanali pjesërisht i integruar, dhe (iv) kanali kryesisht i integruar. Ndërkohë që sasi të mëdha qumështi mbahen në fermë për konsum dhe përpunim, sasi të konsiderueshme qumështi i shiten konsumatorit direkt nga fermerët (në anë të rrugës ose derë më derë) - kanali *i parë* i shitjes informale direkte. Kanali *i dytë* i rëndësishëm është kanali i pakoordinuar - qumështi qarkullon nga fermerët te grumbulluesit e qumështit ose direkt te përpunuesit për t'u përpunuar. Produktet e përpunuara (djathi, gjiza) u shiten shitësve me shumicë, të cilët i transferojnë produktet te shitësit me pakicë. Kanali *i tretë* është kanali pjesërisht i integruar, ku të paktën dy faza të zinxhirit të vlerës kryhen nga i njëjti aktor: përpunuesi merret edhe me grumbullimin edhe me përpunimin e qumështit, ose me përpunimin e qumështit dhe shitjen me shumicë të produkteve të bulmetit, apo me përpunimin, shitjen me shumicë dhe me pakicë; shitësit me shumicë merren me shitjen me shumicë dhe atë me pakicë. Kanali *i katërt* është kanali kryesisht i integruar, ku përpunuesit merren me fazat kryesore të zinxhirit të vlerës - grumbullimin e qumështit, përpunimin e tij, shitjen me shumicë dhe me pakicë; ata ose kanë dyqanet e tyre në qytete, ose ia shesin produktet konsumatorëve nga fabrika.

Flukset financiare. Shumë përpunues të qumështit i bëjnë pagesat me vonesë (për fermerët). Një numër i kufizuar përpunuesish të mëdhenj bëjnë pagesa çdo muaj ose edhe më shpesh. Kur përpunuesit përdorin shërbimin e konsoliduesve/grumbulluesve për të grumbulluar qumështin, zakonisht i paguajnë pa shumë vonesë.

Flukset e informacionit. Përpunuesit e mëdhenj zakonisht angazhohen për t'i ndihmuar fermerët ose udhëzuar për trajtimin e qumështit pas vaksinimit të kafshëve, përdorimit të antibiotikëve dhe për higjienën gjatë dhe pas mjeljes. Disa nga përpunuesit e mëdhenj kanë edhe kontrata me shkrim (p.sh. Gjiofarm) në të cilat parashikohen çështjet e cilësisë së qumështit dhe ato financiare. Një nga fermerët më të mëdhenj të gjedhëve për qumësht deklaroi se profesionalizmi i tij, duke përfshirë përmirësimin e standardeve, vinte kryesisht në sajë të bashkëpunimit të ngushtë me një nga përpunuesit më të mëdhenj të qumështit që ai furnizonte.

Koordinimi i zinxirit të vlerës

Organizimi i zinxirit të vlerës së qumështit është në një fazë relativisht të hershme. Shërbimet e këshillimit të fermerëve nga përpunuesit janë të kufizuara. Megjithatë fermerët i shesin më shumë të njëjtit blerës sesa blerësve të ndryshëm, kjo ndodh kryesisht për shkak të krijimit të një lloji zone ekskluziviteti ku operon secili përpunues qumështi (baxho). Kontratat me shkrim nuk janë të zakonshme.

Megjithatë stadi i organizimit të zinxirit të vlerës, po krijohen modele të organizimit të tij (kutia1).

Kutia 1. Modeli i organizimit të zinxirit të vlerës të „Gjiofarm“

Informacion i përgjithshëm. „Gjiofarm“ është një kompani lider në përpunimin e qumështit, e cila ndodhet në bashkinë e Dropullit. Biznesi është i fokusuar në prodhimin e djathit me cilësi dhe çmim të lartë të llojit Feta. Pjesa tjetër e produkteve të bulmetit (kosi, gjiza etj.) janë më pak të rëndësishme krahasuar me kompanitë e tjera të mëdha (Erzeni, Lufra etj.). Gjiofarm është e pranishme me produktet e saj në të gjitha dyqanet e mëdha dhe të mesme dhe në shumë dyqane të vogla. Shoqëria ka arritur gjithashtu të depërtojë me sukses në tregje të tjera të mëdha të eksportit, si SHBA dhe Hong-Kong, përveç tregut të Kosovës. Kapaciteti përpunues është 30 MT në ditë dhe shfrytëzimi i kapacitetit është pak më i ulët se 50%. Kompania ka në plan të investojë në përmirësimin e sistemit të zinxirit të ftohjes, duke përdorur teknologjinë më bashkëkohore. Kompania ka gjithashtu në plan të investojë për të krijuar një fermë me lopë, një fermë derrash për të përdorur nënproduktet e përpunimit të qumështit si edhe një fabrikë të vogël sallami.

Aktorët. Gjiofarm ka investuar në një teknologji krejtësisht moderne të përpunimit të qumështit. Partnerët e biznesit të Gjiofarm përfshijnë fermerët furnizues dhe grumbulluesit. Fabrika grumbullon qumësht nga 250-300 fermerë. Meqenëse Gjiofarm grumbullon qumësht edhe nga vende më të largëta (Tepelena dhe madje Vlora), fabrika përdor shërbimet e grumbulluesve të qumështit. Dikur ajo kishte ngritur një qendër për grumbullimin e qumështit në Tepelenë.

Fluksi i informacionit. Kompania ka vendosur marrëdhënie mjaft të ngushta me fermerët që e furnizojnë atë. Specialistët e kompanisë këshillojnë fermerët për praktikatat pas mjeljes, duke u fokusuar në veçanti tek trajtimi i qumështit pas përdorimit të vaksinave dhe antibiotikëve.

Flukset financiare. Kompania i paguan fermerët, si rregull, çdo muaj. Për të kapërcyer problemet me likuiditetin, kompania përdor kredinë afatshkurtër (“overdraft”, për të përdorur termin që përdor ajo).

Formalizimi. Gjiofarm ka nënshkruar kontrata me shkrim me fermerët që furnizojnë qumështin. Çështjet kryesore të parashikuara në kontrata janë dorëzimi në kohë, karakteristikat dhe çmimi i produktit, modalitetet e pagesës dhe këshillimi i fermerëve nga kompania.

Mbështetja publike. Rimbursimi i TVSH-së për fermerët ka sjellë përfitime direkte për kompaninë dhe përfitime indirekte për fermerët - kompania e grumbullon qumështin e deles me 100 Lekë/litër; kompania argumenton se për shkak të konjunkturës aktuale të tregut të vogël dhe mungesës së mbështetjes nga qeveria, shoqëria do të ishte e detyruar të ulte çmimin e qumështit. Kompania ka në plan të aplikojë për fondet e IPARD II për të financuar investimet e planifikuara.

Burimi: Përgatitur nga autorët bazuar në intervista

5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT

Feramat e prodhimit të qumështit me një numër të vogël lopësh zakonisht i mjelin lopët me dorë. Vetëm feramat aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi i qumështit (normalisht me më shumë se gjashtë lopë) kanë filluar të blejnë makineri të thjeshta për mjelje. Kur një fermë ka më shumë se 50 lopë, ajo zakonisht investon edhe në një sallë mjeljeje dhe në depozita për ruajtjen e qumështit dhe sisteme ftohjeje.

Bazuar në informacionin e grumbulluar gjatë intervistave përpunuesit e qumështit që u intervistuan ankohen për nivelin e ulët të higjienës dhe për problemet me cilësinë e qumështit të papërpunuar. Pjesa dërrmuese e qumështit vjen nga feramat e vogla, të cilat kanë problemet më të mëdha me standardet e qumështit.

Faktorët që ndikojnë në cilësinë e ulët të qumështit në nivel ferme janë:

- Sistemi i organizimit dhe kushtet josanitare në fermë;
- Sistemi i mjeljes së kafshëve; shumica e lopëve dhe tufave të të imtave milen në vendet ku ato flenë;
- Pajisjet e fermës që përdoren për mjeljen e kafshëve, ruajtjen dhe transportin e qumështit;
- Kushtet shëndetësore të tufave të të imtave;
- Mungesa e njohurive, informacionit dhe aftësive për higjienën e qumështit, shëndetin e gjinjve, teknikat e mjeljes, ruajtjen dhe ftohjen, standardet e sigurisë ushqimore, etj.

Grumbullimi dhe ruajtja e qumështit

Përpunuesit ose grumbulluesit e qumështit zakonisht e grumbullojnë qumështin një herë në ditë në pjesën më të madhe të vitit; lopët zakonisht milen dy herë në ditë. Gjatë verës, kur temperaturat janë të larta, grumbullimi i qumështit bëhet dy herë në ditë (por kjo nuk ndodh gjithmonë).

Siç u përmend më lart, shumica e fermerëve nuk kanë njohuri të mjaftueshme për përmbajtjen mikrobiologjike dhe të cilësisë së qumështit të papërpunuar. Shumica e fermerëve nuk e dinë se cilat institucione janë përgjegjëse për kontrollin e sigurisë ushqimore, shëndetin e kafshëve ose kontrollin e standardeve të stallave. Megjithatë shumica e fermerëve deklarojnë se kanë një regjistër të kafshëve në fermë, ata nuk e dinë se cili është institucioni përgjegjës për kontrollin e tyre¹¹.

Mbarështimi

Racat lokale dominojnë dhe i janë përshtatur mirë kushteve lokale. Në Shqipërinë e veriut, racat kryesore të të leshtave janë Ruda, Bardhoka; dhe racat kryesore të të dhirtave janë: Hasi, Capore, Alpine të kryqëzuara me raca të huaja/franceze. Në Shqipërinë e jugut racat kryesore të të leshtave dhe të dhirtave janë racat vendase të kryqëzuara me ato të huaja/franceze.

¹¹ Gjeci, G., Bicoku, Y., & Imami, D., (2016). Awareness about food safety and animal health standards – the case of dairy cattle in Albania. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*, 22(2), 339–345.

Tabela 16 në vijim paraqet një panoramë të përgjithshme të kategorive kryesore të kostove lidhur me prodhimin e ushqimit për kafshët (p.sh. lopët) dhe shërbime të tjera të lidhura me to. Mbarështimi i të imtave varet shumë nga aksesit në kullota - bizneset për mbarështimin intensiv të të imtave janë të rralla. Për sa i përket modelit të biznesit, vihet re një ndryshim që ndikohet nga vendndodhja. Për hir të krahasimit, ekziston një strukturë e ndryshme mbarështimi që është më tipike për malësitë ose Shqipërinë e veriut, ku çmimi i qumështit është më i ulët (krahasuar me Shqipërinë jugperëndimore), duke bërë që fitimet të jenë më të mëdha në prodhimin e mishit. Në pjesën jugore të Shqipërisë (p.sh. Gjirokastër), meqenëse çmimi i qumështit të deles dhe dhisë është shumë më i lartë se në veri, ka më tepër fitim qengji/keci të shitet sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që të shitet sa më tepër qumësht që të jetë e mundur.

Prodhimi nga gjedhët është fokusuar pothuajse ekskluzivisht tek prodhimet e bulmetit - mishi konsiderohet si nënprodukt. Ka shumë pak raste të fermave të gjedhëve të orientuar drejt prodhimit të mishit, por ky orientim nuk është shumë i suksesshëm për shkak të kostos së lartë të prodhimit dhe konkurrencës së fortë nga çmimet më të lira të importeve nga vende më konkurruese.

Tabela 16: Kalendari i proceseve të prodhimit blegtoral me fokus te gjedhët

Llojet kryesore të shpenzimeve	Muajt												
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
Prodhimi në fermë i ushqimit për kafshët (p.sh. drithërat)													
1. Përgatitja e tokës për prodhimin e foragjereve	■											■	■
2. Plehra bazë dhe plotësues	■	■	■	■	■	■			■				
3. Kullimi i tokës	■	■											■
4. Korrja			■	■	■	■	■	■	■	■			
Blerja e ushqimit për kafshët													
Bagëtitë që kullosin	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Bagëtitë në stalla	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Trajtimi mjekësor													
Trajtimi mjekësor, vaksinimi, etj.			■	■	■	■			■	■	■	■	

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Metodat kryesore për të rritur nivelin e produktivitetit të prodhimit blegtoral janë: (i) përzgjedhja dhe përmirësimi i racës; (ii) zgjedhja e një racioni të balancuar ushqimi në lidhje me nivelin e prodhimit, (iii) kushtet e strehimit dhe kujdesi shëndetësor, (iv) ushqyerja e përshtatshme dhe në kohë, dhe (v) kombinimi i mirë ndërmjet përdorimit të kullotës dhe ushqimit të koncentruar.

Rendimenti mesatar i gjedhit është rreth 2800 litra/vit. Për fermerët e vegjël, me prodhim 2000-3000 litra/vit, norma e konvertimit të ushqimit është 1,1 - 1,3 njësi ushqimi për 1 litër qumësht ndërsa pjelloria është 85-90%, sipas intervistave me ekspertë. Megjithëse shumica e fermave, duke përfshirë ato të voglat, përdorin ndërzimin artificial, ka ende disa zona dhe ferma që përdorin mënyrën natyrale të ndërzimit.

Në tabelën 17 në vijim paraqitet një panoramë e përgjithshme e kalendarit të prodhimit të qumështit, e cila është një tregues për të ardhurat (fermerët zakonisht paguhen 2-4 javë pas dorëzimit të qumështit, ose 2-3 herë në muaj).

Tabela 17: Kalendar i prodhimit të qumështit

Lloji	Muajt											
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Dele												
Koha e prodhimit të lartë												
Koha e prodhimit mesatar												
Koha e prodhimit të ulët												
Koha pa prodhim												
Dhi												
Koha e prodhimit të lartë												
Koha e prodhimit mesatar												
Koha e prodhimit të ulët												
Koha pa prodhim												
Shënim: Në disa qarqe ka dy periudha laktacioni. Në këtë rast, gjatë tetorit, nëntorit dhe dhjetorit ka prodhim qumështi.												
Lopë												
Koha e prodhimit të lartë												
Koha e prodhimit mesatar												
Koha e prodhimit të ulët												
Shënim: Vlerësimet për të imtat i referohen rastit të zakonshëm (bazuar në kullotje të lirë). Për bagëtitë në stalla, kjo panoramë ndryshon në varësi të sezonit të ndërzimit.												

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat

Mospërputhja mes shpenzimeve (që priren të shtrihen përgjatë gjithë vitit) dhe të ardhurave (p.sh. në kohën kur shiten viçat, qengjat ose kecat, si edhe qumështi) mund të paraqesë një potencial për kredi afatshkurtra.

6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM

6.1. STRATEGJIA BAZUAR NË ANALIZËN SWOT

Strategjia e mëposhtme bazuar në analizën SWOT synon identifikimin e mundësive për financim në sektorin e qumështit.

Tabela 18: Sektori i qumështit: Strategjia për analizën SWOT

	PIKAT E FORTA (S) (+)	PIKAT E DOBËTA (W) (-)
	Kullotat në Shqipëri janë të pasura/cilësore (për kullotje)	Racat e papërshtashme rezultojnë në rendiment të ulët të qumështit.
	Tradita e gjatë në mbarështimin e bagëtisë	Përmasa e vogël e fermave që e bën të kushtueshëm prodhimin e ushqimit për kafshët dhe varësia e lartë nga importet e shtrenjta.
	Investimet në fermat bashkëkohore të qumështit (kryesisht me lopë) nga një numër i konsiderueshëm fermerësh të orientuar drejt biznesit	Burimet e pamjaftueshme të ushqimit, veçanërisht gjatë dimrit; mirëmbajtja e ulët e kullotave dhe livadheve
	Investimet në ambiente dhe teknologji bashkëkohore nga një numër i konsiderueshëm i fabrikave të përpunimit të qumështit	Stallat e papërshtatshme
		Siguria dhe cilësia e dobët e qumështit
		Infrastruktura e dobët për grumbullimin e qumështit
		Teknologjia e vjetruar e përpunimit të qumështit dhe (shpesh) pajisjet jo të plota për baxhot më të vogla
		Mungesa e sistemeve të përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve në fermat e mëdha dhe baxho
		Investimet e kufizuara në përpunimin e nënprodukteve blegtorale
MUNDËSITË (O) (+)	STRATEGJIA PËR S (+) / O (+)	STRATEGJIA PËR W (-) / O (+)
Mundësia për të blerë kafshët të racave me prodhimytari të lartë		Mbështetja për përmirësimin e racave
Kërkesë e brendshme e qëndrueshme për produktet e bulmetit/ djathë	Mbështetja për të rritur kapacitetet e përpunimit të qumështit	Mbështetja për përmirësimin e infrastrukturës në kullota, përfshirë pikat për shpërndarjen e ujit
Potenciali për të rritur numrin e kafshëve	Mbështetja e investimeve në diversifikimin e përpunimit të qumështit, duke përfshirë kosin e frutave dhe pijet me kos	Mbështetja për rritjen e numrit të kafshëve, duke mbështetur në veçanti fermat e mëdha

Mbështetja nga donatorët për investime dhe asistencë teknike për përmirësimin e standardeve		Mbështetja për përmirësimin dhe plotësimin e teknologjisë në baxhot e vogla e të mesme
		Mbështetja për ndërtimin/rinovimin e stallave
		Mbështetja për sistemet e përpunimit dhe asgjësimit të mbetjeve
		Mbështetja për sistemet ftohëse për grumbullimin e qumështit
Sasia e mjaftueshme e nënprodukteve me origjinë shtazore (lëkura dhe të tjera)		Mbështetja për industrinë përpunuese të nënprodukteve me origjinë shtazore
		Mbështetja e investimeve në kapacitetet e kontrollit të sigurisë dhe cilësisë në nivel përpunuesi, duke synuar operatorët e mesëm dhe të mëdhenj.
KËRCËNIMET (T) (-)	STRATEGJIA PËR S (+) / T (-)	STRATEGJIA PËR W (-) / T (-)
Mungesa e eksporteve të konsiderueshme deri më sot – problemet me furnizimin e kufizuar dhe sigurinë		Mbështetja e investimeve të lidhura me furnizimin dhe sigurinë (si më lart)

Burimi: Përgatitur nga autorët

6.2. NEVOJAT PËR FINANCIM

6.2.1. Tendencat për investime dhe nevojat për financim

Tendencat për investime

Fermat me gjedhë aktiviteti kryesor i të cilave është prodhimi i qumështit (normalisht me më shumë se gjashtë lopë) kanë prirjen të investojnë në makineri për mjelje. Fermerët që kanë më shumë se 50 lopë kanë më tepër gjasa që të investojnë në depozita ftohëse. Disa ferma që synojnë të vazhdojnë veprimtaritë e tyre bujqësore për një afat të gjatë prirjen të investojnë në blerjen e mëshqerrave, përmirësimin e stallave të thjeshta të gjedhëve, dhe përmirësimin e sistemeve të ushqyerjes me qëllim për t'u specializuar në prodhimin e qumështit. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit është vënë re ngritja e disa fermave të reja me gjedhë për qumësht me pajisje bashkëkohore dhe me më shumë se 50 lopë për fermë. Këto lloje fermash për produktet e bulmetit kanë një produktivitet shumë më të lartë se shumica e fermave shumë të vogla me 1-2 lopë. Të dhënat tregojnë se ka pasur një rritje të numrit të deleve dhe dhive gjatë viteve të fundit. Fermat e të imtave me tufa më të mëdha kanë investuar gjithashtu në përmirësimin e stallave. Në disa raste, fermerë të rinj futen në sektorin e të imtave duke investuar në blerjen e deleve dhe dhive –janë vënë re disa raste të bizneseve të reja në mbarëshkrimin e të dhirtave që kanë bërë investime të konsiderueshme.

Fabrikat e mëdha të konsoliduara të përpunimit të qumështit kanë investuar në sistemin e ftohjes në grumbullimin e qumështit (depozita (tank) ftohëse që instalohen tek fermerët dhe kamionët frigoriferik). Instalimi i zinxhirit të ftohjes në nivel fermerësh është bërë kryesisht në fermat kryesisht të mëdha të lopëve dhe jo në fermat me të imta. Investimet në sistemin e ftohjes të të imtat priten

që të jenë të kufizuara për shkak se këto ferma ndodhen në zona të thella ku mungon energjia elektrike. Janë vënë re gjithashtu investime në fabrika të reja të përpunimit të qumështit ose në rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e teknologjive ekzistuese të përpunimit të qumështit në zona ku ka potencial për prodhimin e qumështit nga të imtat. Në disa raste, këto lloj investimesh janë mbështetur nga projektet donatore. Edhe përpunuesit e mëdhenj kanë bërë investime të konsiderueshme në logjistikën e shpërndarjes - zakonisht ata furnizojnë direkt shitësit me pakicë.

Nevojat e financimit për investime

Duke u mbështetur në strategjinë e bazuar në analizën SWOT dhe tendencat e investimeve, nevojat e financimit për investime janë përmbledhur në tabelën 19.

Tabela 19: Nevojat e financimit për investime

Lloji i investimit	Fermerët	Konsoliduesit	Përpunuesit
1. Mbështetja për blerjen e kafshëve për ngritjen e fermave të reja për prodhimin e qumështit duke përdorur raca të përmirësuara të kafshëve - kryesisht lopë, por edhe dele dhe dhi			
2. Ndërtimi i stallave të reja dhe rinovimi i atyre ekzistuese			
3. Mbështetja për sistemet e përpunimit / trajtimit / eliminimit të mbetjeve			
4. Përmirësimi i kushteve të ujit për kafshët në kullota - ndërtimi i lerave			
5. Përmirësimi i ushqimit të kafshëve duke mbështetur mekanikën bujqësore, ujitjen dhe farat e certifikuara			
6. Mbështetja për zinxhirin e ftohjes në nivel përpunuesi (dhe mundësisht në nivel grumbulluesi të qumështit), me qëllimin për të përmirësuar sigurinë dhe cilësinë e produktit			
7. Mbështetja për rritjen dhe përmirësimin e kapacitetit të përpunimit të qumështit (ndërtimi dhe rinovimi i baxhove, zgjerimi i kapaciteteve përpunuese ose investimi në linja të reja të përpunimit të qumështit)			
8. Mbështetja e bizneseve të lidhura me përdorimin e nënprodukteve të qumështit - mbarështimi i derrave dhe prodhimi i sallamit			
9. Mbështetja për ndërtimin e fabrikave përpunuese të nënprodukteve në zona blegtorale premtuese (me potencial).			
10. Mbështetja për investimet në pajisjet e kontrollit të sigurisë dhe cilësisë (p.sh. laboratorë të vegjël) për përpunuesit e mesëm.			

Burimi: Puna e autorëve

Përmirësimi i efikasitetit dhe shqetësimi për të përmbushur standardet në nivel përpunuesi ka motivuar një numër biznesesh të investojnë në ngritjen e fermave më të mëdha të qumështit (me lopë dhe të imta), blerjen e racave më të mira dhe përmirësimin e stallave. Këto lloj investimesh përbëjnë një mundësi të mirë për institucionet financiare, edhe pse ato duhet të trajtohen me kujdes - investitorët e rinj që hyjnë në sektorin e fermave për produkte bulmeti janë të ekspozuar ndaj rreziqeve më të larta (duke pasur parasysh vështirësitë në këtë sektor). Investime të tjera që

mund të merren në konsideratë për fermat e mëdha me lopë janë trajtimi i mbetjeve (përpunimi i plehut), prodhimi i biogazit dhe prodhimi i energjisë diellore (panelet diellore në çatitë e stallave).

Ndërkohë që investimet e reja në përpunimit të qumështit duhet të shqyrtohen me shumë kujdes për shkak të rreziqeve që i shoqërojnë - rreziku që lidhet me furnizimin, marketingun dhe teknologjinë - ekziston një mundësi reale për të mbështetur përmirësimin e teknologjisë dhe rritjen e kapaciteteve për përpunuesit e qumështit që tashmë kanë hedhur baza të forta. Diversifikimi i produkteve (prodhimi i kosit, kosit të frutave, qumështit të paketuar) mund të konsiderohen me kujdes nga ata që ende nuk i prodhojnë këto lloj produktesh. Sistemi i ftohjes së qumështit - nga ferma të përpunuesit - ende nuk është ngritur. Vetëm kompanitë e mëdha të industrializuara (si p.sh. Erzeni, Gjirfarm, Lufra) kanë investuar në sistemet e ftohjes, por ka ende shumë për të bërë. Mundësitë për të financuar në zinxhirin e ftohjes së qumështit janë reale. Aktorët e synuar në këto lloj investimesh janë përpunuesit (e mëdhenj) të qumështit dhe grumbulluesit.

Disa kompani të mëdha të përpunimit të qumështit (p.sh. Gjirfarm) kanë plane për të investuar në biznese të reja të lidhura me përpunimin e nënprodukteve të qumështit. Një biznes i tillë është mbarështimi i derrave dhe ndoshta edhe prodhimi i sallamit. Këto plane mund të shqyrtohen me kujdes nga institucionet financiare. Mbështetja për ndërtimin e fabrikave të përpunimit të nënprodukteve blegtorale (lëkura etj.) në zona premtuese blegtorale, mund të merret gjithashtu në konsideratë, pavarësisht se duhet të shqyrtohet me shumë kujdes duke qenë se është një projekt shumë i madh. Sipas ekspertëve të intervistuar, duke qenë se kontrolli i standardeve të sigurisë ushqimore pritet që të forcohet, përpunuesit e produkteve të bulmetit duhet të investojnë në kapacitetet e brendshme për kontrollin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë (p.sh. laboratorët e brendshëm).

Kutia 2: Skemat publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare

Ka dy skema kryesore publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare, përkatësisht Skemat Kombëtare të Mbështetjes (SKM) që jepen çdo vit dhe mbështetja nga BE, si Programi për Zhvillimin Rural, IPARD. Ndërkohë që ky i fundit synon të rrisë konkurrueshmërinë dhe të zbatojë standardet e BE-së (siguria, cilësia dhe mjedisi) dhe synon bizneset më konkurruese, SKM ka politika me shumë objektiva dhe një shtrirje më të gjerë.

Objektivat dhe masat për SKM 2018 janë përmbledhur në vijim:

- Rritja e konkurrueshmërisë duke ofruar mbështetje për investime (investime në agro-përpunim dhe marketing), mbështetja e teknologjive të inovacionit dhe certifikimit dhe siguracionit
- Përmirësimi i sigurisë ushqimore duke mbështetur investimet në përmirësimin e sigurisë së zinxhirit ushqimor të produkteve blegtorale; dhe masa të tjera për rritjen e sigurisë ushqimore, si p.sh. identifikimi dhe regjistrimi i kafshëve, mbështetja për sistemet e dorëzimit të sigurt të qumështit, ruajtjes dhe transportit të sigurt të qumështit dhe të ngjashme.
- Formalizimi vertikal dhe horizontal dhe formalizimi i biznesit
- Diversifikimi i veprimtarive rurale.

Ndërkohë që SKM-të tradicionalisht kanë ofruar mbështetje për të përmbushur disa objektiva, duke përfshirë rritjen e konkurrencës, kohët e fundit është shtuar vëmendja për arritjen e standardeve të sigurisë së ushqimit, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Skemat kombëtare të subvencionimit tradicionalisht kanë ndryshuar nga viti në vit (shpesh në mënyrë drastike). Buxheti i alokuar për SKM 2018 është 20 milion euro. Për mbështetjen për investime është e vlefshme edhe skema e ngjashme e politikave të granteve të pjesshme (të paktën 50% mbështetje publike).

Një program tjetër i rëndësishëm është programi i BE-së, IPARD - Programi i Masave për Zhvillimin Rural, i cili mundëson mbështetje për investime që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së nëpërmjet investimeve të bashkëfinancuara nëpërmjet një granti (p.sh. 50%, megjithatë vlera e saktë varet nga një sërë kriteresh). Për këtë program është miratuar një buxhet në formë granti prej 71 milionë euro nga KE dhe 24 milionë euro nga qeveria shqiptare (75% BE: 25% qeveria shqiptare), kështu që është i disponueshëm një grant për investime prej 94 milionë euro në nivel ferme dhe nivel përpunuesish përgjatë periudhës 2014-2020.

6.2.2. Nevojat për financime për kapital qarkullues

Tendencat e financimeve për kapital qarkullues

Procesi i teknologjisë së djathit - djathi bëhet gati për shitje dy muaj pasi qumështi furnizohet nga fermerët - çon pa diskutim në stoqe dinamike të produktit. Rezulton se, përveç kompanive të mëdha me baza të forta, shumica e përpunuesve bëjnë pagesa të mëvonshme për furnizuesit e qumështit. Zakonisht, përpunuesit e vegjël të qumështit bëjnë marrëveshje me gojë me fermerët për shtrirjen e pagesave. Ata i paguajnë fermerët pjesërisht sapo të arrijnë të shesin produktin dhe, në rastin më të mirë, llogaritë shlyhen në fund të vitit kalendarik.

Kompanitë e mëdha të përpunimit të qumështit sillen ndryshe. Ata i paguajnë furnizuesit e qumështit çdo muaj (rasti i Gjirofarm) ose edhe në periudha më të shkurtra kohore (për shembull, Erzeni i paguan fermerët në datën 2, 12 dhe 22 të çdo muaji). Për të zgjidhur problemin e likuiditetit, këto kompani shpesh përdorin kreditë afatshkurtra.

Si kompanitë e mëdha edhe ato të vogla të përpunimit të qumështit kanë nisur t'i paguajnë furnizuesit e qumështit nëpërmjet sistemit bankar. Ky është një fenomen i kohëve të fundit


Nevojat për financime për kapital qarkullues

Shumë fabrika të përpunimit të qumështit kanë probleme me likuiditetin që lidhen me procesin e teknologjisë së djathit. Kjo nevojë manifestohet më tepër nga kompanitë e mëdha të përpunimit të qumështit, të cilat i janë drejtuar gjithashtu kredive afatshkurtra për ta zgjidhur këtë nevojë.

6.2.3. Financimi sipas qasjes së zinxhirit të vlerës

Flukset (e produkteve, financiare dhe informacionit) ndërmjet përpunuesve të qumështit dhe fermerëve përmban potencial për financime bazuar në qasjen e zinxhirit të vlerës. Figura 3 në vijim paraqet të përmbledhur mënyrën sesi mund të projektohet financimi sipas qasjes së zinxhirit të vlerës.

Figura 3: Financimi sipas qasjes së zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit



Marrëdhëniet ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve të mëdhenj e të konsoliduar të qumështit në zinxhirin e vlerës së qumështit janë mjaft të qëndrueshme. Fermerët i shesin shumicën e qumështit përpunuesve, të cilët zakonisht paguajnë në kohë (disa çdo 2 javë, të tjerë çdo 10 ditë). Për t'i paguar fermerët në kohë, përpunuesit përdorin kreditë afatshkurtra nga banka tregtare dhe i transferojnë paratë në llogarinë bankare të fermerit - transferimi i parave në llogaritë bankare të fermerëve është një fenomen i kohëve të fundit në Shqipëri. Kur konsoliduesi/përpunuesi shet produktin, ai shlyen kredinë. Megjithatë, duhet theksuar se konsoliduesi mund t'i japë bankës informacione të rëndësishme për fermerët, duke përfshirë kohën e transferimit të parave në llogaritë bankare të fermerëve.

Për të ofruar financim sipas qasjes së zinxhirit të vlerës në sektorin e qumështit duhet të shqyrtohen me kujdes dy kushte paraprake, përkatësisht: madhësia e kompanisë dhe konkurrenca e kompanive për të siguruar furnizimin e nevojshëm me qumësht. Kompanitë e synuara për financimin sipas qasjes së zinxhirit të vlerës duhet të jenë të mëdha e të konsoliduara. Gjithashtu, në mënyrë që kompanitë të motivohen për t'i paguar fermerët në kohë, duhet të operojnë në një mjedis konkurrues. Në rastin e një blerësi të vetëm (monopsoni) ose një numri të kufizuar blerësish (oligopsoni), edhe kompanitë e mëdha priren të shfaqin një farë oportunitizmi dhe vonojnë pagesat për fermerët.

Bankat tregtare mund të konsiderojnë gjithashtu që të financojnë fermerët duke përdorur informacionet e dhëna nga kompanitë e përpunimit të qumështit dhe vetëm në raste përjashtimore duke përdorur garancinë e ofruar nga përpunuesit.

7. PËRFUNDIME

Që në fillim të viteve 2000, prodhimi i qumështit (dhe produkteve të bulmetit) ka pësuar rritje. Ndërkohë që numri i gjedhëve ka pësuar rënie, prodhimi i qumështit është rritur duke konfirmuar një përmirësim të rendimentit (efiçencës), e nxitur kjo nga investimet në raca dhe menaxhim; ky i fundit është tipik në për fermate mëdha numri i të cilave është në rritje.

Në përgjithësi, prodhimi i produkteve të bulmetit ka si destinacion tregun e brendshëm, kështu që rritja e prodhimit është e nxitur kryesisht nga rritja e kërkesës vendase. Bilanci tregtar i produkteve të bulmetit tregon një deficit strukturor, por shumë më të ulët se deficiti (i tregtisë ndërkombëtare) në tregtinë e mishit (kështu që, brenda sektorit të blegtorisë, bulmeti duket se ka performancë më të mirë se prodhimi i mishit). Për shkak të kushteve të tregut dhe kufizimeve në prodhim (kostot për ushqimin e kafshëve në Shqipëri janë më të larta se në vendet e tjera të rajonit), deficiti tregtar i produkteve të bulmetit duhet të konsiderohet si strukturor për shkak të mangësive në standarde dhe për shkak të kufizimit strukturor (që lidhen me madhësinë e vogël të fermës) të sektorit blegtoral.

Prodhimi i qumështit vjen kryesisht nga ferat e vegla gjysmë të specializuara dhe nga fermat me aktivitet të përzier. Qumështi i lopës vjen kryesisht nga zonat e ulëta dhe kodrinore; mbarështimi i të imtave për qumësht është i përqendruar në jug, ku ndodhen edhe fabrikat e specializuara të djathit.

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të qumështit për mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor. Këto mundësi përfshijnë mbështetjen për të rritur numrin e krerëve (lopë, dele dhe dhi), financimin e ndërtimit të stallave për kafshët, mbështetjen e zinxhirit të ftohjes në nivel përpunuesi, mbështetjen e përmirësimit të teknologjisë së qumështit dhe rritjes së kapaciteteve. Investime të tjera që mund të konsiderohen për mbështetje janë edhe mbështetja e bizneseve që lidhen me përdorimin e mbetjeve nga përpunimi i qumështit, ose edhe mbështetja për projekte më të mëdha që trajtojnë përpunimin e mbetjeve, përmirësojnë teknologjinë e prodhimit të ushqimit për kafshët, kushtet e kullotave apo investime në lidhje me standardet për bujqësinë ose përpunimin.

Evidencat nga terreni na tregojnë se ka një tendencë të lehtë për rritjen e numrit të bagëtive të qumështit, kryesisht lopë, por edhe dele dhe dhi, ose nëpërmjet rritjes së përmasës së tufave, ose duke ngritur ferma të reja. Këto ferma më të mëdha kanë më shumë gjasa të përmirësojnë kushtet në stalla - dhe shpesh e bëjnë diçka të tillë. Kështu që kjo paraqet një mundësi për të mbështetur investimet në nivel ferme.

Grumbullimi dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Në shumicën e rasteve qumështi nuk mbahet në kushte ftohjeje gjatë gjithë periudhës së ruajtjes në fermë dhe gjatë transportit drejt fabrikës së përpunimit. Ndaj, ekziston një mundësi e dukshme për të financuar këtë fazë të zinxhirit të vlerës, me një preferencë për përpunuesit e mëdhenj dhe grumbulluesit.

Duke parë tendencën aktuale të investimeve nga kompanitë lider në industrinë e përpunimit të produkteve të bulmetit (Gjirofarm, Lufra, Erzeni, etj.) për të investuar në teknologji bashkëkohore të përpunimit të qumështit, institucionet financiare mund të shfrytëzojnë rastin që të mbështesin këtë tendencë. Investime priten në baxho me kapacitet 4-10 MT në ditë (të mesme për standardet

shqiptare) në funksion të konsolidimit të ngadaltë të sektorëve të përpunimit, me qëllim rritjen e efikasitetit, përmirësimin e cilësisë dhe prezantimin e ambalazhimit më të mirë dhe produkteve të reja. Investimet për ngritjen e bizneseve të reja (start ups) të përpunimit të qumështit mund të merren gjithashtu në konsideratë, megjithëse me shumë kujdes, duke qenë se janë me risk të lartë.

Mund të merret në konsideratë edhe mbështetja e biznesit të lidhur me mbetjet nga përpunimi i qumështit, impiantet e përpunimit të mbetjeve, teknologjisë së prodhimit të ushqimit për kafshët, përmirësimin të kushteve të kullotave dhe investimeve të lidhura me standardet për bujqësinë dhe përpunimin.

Sektori i qumështit konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare. Politika aktuale e granteve të pjesshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ato kanë mundësinë për të bashkë financuar investimet (stallat, zinxhiri i ftohjes, përpunimi i qumështit etj.) për investimin e 100% të shumës, nga e cila të paktën 50% mund të jetë kredi afatshkurtër (pjesa që duhet të rimbursohet nga granti pas kryerjes së investimit) dhe maksimumi 50% kredi afatgjatë për pjesën që duhet të paguhet nga përfituesi.

8. BIBLIOGRAFIA

EC (2017). EU Agricultural Outlook for The Agricultural Markets and Income 2017-2030

Eurostat (2018). <http://ec.europa.eu/eurostat>

FAOSTAT (2018). Baza e të dhënave gjendet në <http://www.fao.org/faostat/en/>?

FAO (2014). Studim për sektorin e produkteve të bulmetit

Gjeci, G., Bicoku, Y., & Imami, D., (2016). Awareness about food safety and animal health standards – the case of dairy cattle in Albania. *Bulgarian Journal of Agricultural Science*, 22(2), 339–345.

Imami, D., Zhllima, E., Merkaj, E., Chan-Halbrendt, C., & Canavari, M. (2016). Albanian Consumer Preferences for the use of Powder Milk in Cheese-Making: A Conjoint Choice Experiment. *Agricultural Economics Review*, 17(1), 20.

Imami, D., Chan-Halbrendt, C., Zhang, Q., & Zhllima, E. (2011). Conjoint analysis of consumer preferences for lamb meat in central and southwest urban Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 14(3).

Imami, D., Engjell, S., Maurizio, C., Catherine, C., & Alban, C. (2016). Analysis of consumers' preferences for typical local cheese in Albania applying conjoint analysis. *New Medit*, 15(3), 49-55.

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

INSTAT (2017). Baza e të dhënave gjendet në www.instat.gov.al

UNSTAT (2018). Baza e të dhënave për tregtinë <https://comtrade.un.org/data/>

Verçuni, A., Zhllima, E., Imami, D., Bijo, B., Hamiti, X., & Bicoku, Y. (2016). Analysis of consumer awareness and perceptions about food safety in Tirana, Albania. *Albanian Journal of Agricultural Sciences*, 15(1), 19.

Zhllima, E., Imami, D., & Canavari, M. (2015). Consumer perceptions of food safety risk: Evidence from a segmentation study in Albania. *Journal of Integrative Agriculture*, 14(6), 1142-1152.

